

# **RAPORT**

## **NGA ANGAZHIMI INSTITUCIONAL**

### **TE VEPRIMI QYTETAR:**

## **MONITORIMI I ZBATUESHMËRISË SË PLANIT TË**

### **INTEGRITETIT TË BASHKISË PUKË (2024)**



Ky material, është mundësuar me mbështetjen financiare të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC-së). Përmbajtja e tij është përgjegjësi e shoqatës Together for Life, opinioni i shprehur në të nuk është domosdoshmërisht opinion i AMSHC-së.

**Ekspertë të Raportit:**  
Ina Xhepa, Eksperte Ligjore

Autor: © TOGETHER FOR LIFE

Rr. Brigada VIII, Tiranë, Shqipëri

Email: [info@togetherforlife.org.al](mailto:info@togetherforlife.org.al)

Web: [www.togetherforlife.org.al](http://www.togetherforlife.org.al)

# PËRMBAJTJA



<b>Hyrje.....</b>	<b>4</b>
<b>Metodologjia.....</b>	<b>6</b>
<b>IV - Kuptimi i përgjithshëm i Planit të Integritetit.....</b>	<b>7</b>
<b>V - Kuptimi dhe zhvillimi historik i planit të integritetit të Bashkisë Pukë.....</b>	<b>8</b>
<b>VI - Faza e zbatimit të Planit të Integritetit sipas objektivave dhe prioriteteve.....</b>	<b>10</b>
<b>VII - Vështrim krahasimor i përmbushjes së objektivave të PI ndërmjet viteve.....</b>	<b>19</b>
<b>VIII - Transparenca në faqen zyrtare të Bashkisë pukë dhe aksesimi në informacion.....</b>	<b>26</b>
<b>IX - Qasja vetëvlerësuese e bashkisë pukë në përmbushjen e planit të integritetit dhe zgjatja e afatit.....</b>	<b>28</b>
<b>X - Rëndësia e përfshirjes qytetare ex ante dhe ex post vendimarrjes së pushtetit vendor.....</b>	<b>30</b>
<b>XI - Format aktuale të monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë në dispozicion të qytetarëve.....</b>	<b>31</b>
<b>XII - Niveli aktual i informimit dhe ndërgjegjësimit qytetar mbi Planet e Integritetit të Bashkisë Pukë.....</b>	<b>34</b>
• <i>Njohja me dokumentin e planit të integritetit të Bashkisë Pukë.....</i>	<i>34</i>
• <i>Transparenca e Bashkisë Pukë nën optikën e perceptimit qytetar.....</i>	<i>35</i>
<b>XIII - Gjetjet kryesore.....</b>	<b>40</b>
<b>XIV - Rekomandime.....</b>	<b>41</b>
<b>XV - Referenca.....</b>	<b>42</b>

# I.HYRJE



Integriteti institucional përbën një shtyllë themelore të mirëqeverisjes dhe shtetit të së drejtës dhe është i lidhur ngushtë me besimin e qytetarëve në institucionet publike, transparencën e veprimit shtetëror dhe mekanizmat e llogaridhënies. Në një kohë kur politikat tradicionale kundër korrupsionit të fokusuar thjesht në forcimin e kuadrit ligjor apo rritjen e sanksioneve shpesh duken të pamjaftueshme, koncepti i integritetit publik ofron një qasje më gjithëpërfshirëse për të adresuar jo vetëm rastet e praktikave korruptive, por edhe për të ndërtuar një kulturë të qëndrueshme etike brenda institucioneve të qeverisjes së vendit dhe vetëqeverisjes vendore. Kjo qasje synon të integrojë parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë në funksionimin e administratës publike, duke ulur nevojën për ndërhyrje reaktive dhe duke fuqizuar besimin e publikut në proceset vendimmarrëse dhe shërbimet publike. Në këtë kontekst, Bashkia Pukë, në përputhje me kuadrin strategjik dhe legjislativ të vendit, nëpërmjet vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 4, datë 29.06.2022, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për vitin 2022-2025, si një instrument parandalues dhe sistem i menaxhimit të rrezikut të integritetit që synon nxitjen e sjelljeve etike dhe funksionimin transparent të të gjitha hallkave të administratës vendore.

**“Integritas est tutamen”- Integriteti është mburojë.** Kjo përbën një nga shprehjet më të lashta latine dhe me rëndësi të cilat përmblendh thelbin e mirëqeverisjes. Sipas kuptimit të këtij parimi pa integritet, institucionet humbasin aftësinë e tyre për t'i shërbyer qytetarëve në mënyrë të drejtë, transparente dhe të përgjegjshme. Detyrimet e organeve të vetëqeverisjes vendore si organe të zgjedhura nga vetë qytetarët nuk mund të konsiderohet një mandat i thjeshtë ligjor por një formë e ushtrimit të sovranitetit të popullit përmes të zgjedhurve të tij. Pikërisht, për të vlerësuar se si është arritur të realizohet ky lloj mandati nga Bashkia Pukë, TFL ka ndërmarrë një iniciativë të përbashkët me qytetarët e Bashkisë Pukë për të sjellë përmes këtij raporti një dimension tjetër të mënyrës së ushtrimit të një pjese të këtij sovraniteti përmes monitorimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë.

Ky raport synon të ofrojë një vlerësim objektiv dhe të paanshëm të zbatueshmërisë së Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë për vitin 2024, duke evidentuar progresin e arritur, sfidat kryesore dhe nevojën për përmirësime të mëtejshme në planifikim, **zbatim dhe monitorim. Teknikat e zbatuara janë mbështetur për analogji në metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, Nr 553 datë 30.09.2021 “Për miratimin e metodologjisë së monitorimit të planit të integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore.” Si një dokument që parashikon teknika të avancuara monitorimi, është zbatuar për aq sa ka qenë e mundur dhe në koherencë edhe me modelet raporteve të monitorimit të kryera nga AMVV-ja si institucioni përgjegjës për monitorimin e planeve të integritetit në nivel vendor.** Thënë sa më sipër, ky raport synon të ofrojë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të performancës së planit dhe ndikimit të tij në promovimin e integritetit institucional dhe pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse të Bashkisë Pukë. Ky qasje jo vetëm që ndihmon në identifikimin e mangësive dhe arritjeve, por gjithashtu shërben si një bazë për rekomandime të qarta dhe të zbatueshme për politikat publike vendore.

# II.SHKURTESA



PI	Plani i Integritetit
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
SNKK	Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
SNDQV	Strategjia Ndërsektorale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

# III.METODOLOGJIA



Procesi i monitorimit të zbatueshmërisë së Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë për vitin 2024 është mbështetur në një kombinim metodash cilësore dhe analitike, të cilat kanë mundësuar një vlerësim gjithëpërfshirës të progresit institucional dhe nivelit të përfshirjes qytetare.

Së pari, është aplikuar **analiza dokumentare dhe ligjore**, si metodë bazë, përmes shqyrtimit të Planit të Integritetit dhe kuadrit përkatës normativ. Kjo analizë ka synuar identifikimin e elementeve kyçe të planit, detyrimeve institucionale për zbatimin e tij, si edhe vlerësimin e angazhimit të shtetit shqiptar në garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit në nivel të vetëqeverisjes vendore.

Në vijim, është përdorur **metoda e kërkimit të thelluar (desk research)**, përmes mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nga burime publike dhe institucionale, përfshirë faqen zyrtare të Bashkisë Pukë, Programin e Transparencës, raporte monitoruese të institucioneve shtetërore, si dhe informacionin e siguruar përmes kërkesave shkresore drejtuar Bashkisë Pukë. Të dhënat e mbledhura janë trajtuar përmes një analize cilësore.

Një komponent thelbësor i metodologjisë ka qenë **përfshirja e qytetarëve në procesin e monitorimit**, si metodë pjesëmarrëse, me qëllim verifikimin dhe kryqëzimin e informacionit të marrë nga burimet institucionale. Në këtë kuadër, është administruar një pyetësor jo në formën e një ankete i cili është shpërndarë tek pjesëmarrësit përgjatë sesioneve të konsultimit. Përgjigjet e dhëna nuk përbëjnë rezultatet e një ankete të mirfilltë por ka pasur si qëllim lehtësimin e përpunimit të të dhënave mbi njohuritë për Planin e Integritetit të qytetarëve të përfshirë në sesionet informuese dhe konsultative të realizuar. Rezultatet e përpunuara kanë orientuar më tej hapat e ndërmarra për monitorimin e zbatueshmërisë së PI-së dhe nivelin e përfshirjes qytetare.

Paralelisht, është aplikuar **metoda e triangulimit të të dhënave**, përmes krahasimit dhe ndërthurjes së informacionit të siguruar nga burime të ndryshme, përfshirë pyetësorët me qytetarët, monitorimin e pavarur të faqes zyrtare të institucionit, raportet e mëparshme të monitorimit dhe përgjigjet zyrtare të Bashkisë Pukë.

Për qëllime prezantimi dhe lehtësimi të asimilimit të informacionit nga publiku, janë përdorur edhe **teknika tabelare të sistematizimit të të dhënave**, si mjet mbështetës për paraqitjen e gjetjeve mbi nivelin e zbatimit të Planit të Integritetit.

Së fundi, në masën e mundshme, është angazhuar edhe **publiku i gjerë përmes një grupi konsultativ**, i cili ka kontribuar me opinione dhe sugjerime gjatë fazave të ndryshme të monitorimit dhe mbi instrumentet e përdorura, duke forcuar dimensionin pjesëmarrës të procesit.

# VI. KUPTIMI I PËRGJITHSHËM I PLANIT TË ITEGRITETIT



Planet e integritetit përfaqësojnë një instrument bashkëkohor të qeverisjes së mirë, i orientuar drejt parandalimit proaktiv të korrupsionit dhe forcimit të standardeve etike në institucionet publike. Në nivel ndërkombëtar, megjithëse nuk ekziston një përkufizim unik juridik, koncepti i planeve të integritetit buron nga parimet e përcaktuara në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) dhe nga rekomandimet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) për integritetin publik, të cilat theksojnë nevojën për politika të koordinuara, të bazuara në vlerësimin e riskut, transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje publike.

Në këtë kuadër, plani i integritetit për nga përmbajtja dhe qëllimi, kuptohet si një kornizë e strukturuar institucionale që synon identifikimin e praktikave korruptive apo tentativave ndaj korrupsionit dhe sjelljeve joetike, analizimin e proceseve të brendshme me risk të lartë, si dhe përcaktimin e masave parandaluese, përgjegjëse dhe mekanizmeve të monitorimit për garantimin e zbatimit efektiv. Edhe në kuadrin normative të Bashkimit Europian, ndonëse nuk ka një përkufizim të detyrueshëm të unifikuar për “planin e integritetit”, politikant antikorrupsion dhe kuadri i integritetit publik promovojnë qartësisht qasjen parandaluese përmes sistemeve të menaxhimit të riskut, forcimit të etikës në administratë dhe rritjes së transparencës institucionale, veçanërisht në kontekstin e përdorimit të fondeve publike dhe proceseve vendimmarrëse.

Në këtë kuptim, planet e integritetit shihen si mekanizma praktikë për operacionalizimin e këtyre parimeve, duke shërbyer jo vetëm si mjete teknike të kontrollit të brendshëm, por edhe si instrumente për ndërtimin e besimit publik dhe fuqizimin e kulturës së përgjegjshmërisë në administratën publike, në përputhje me standardet europiane dhe praktikant më të mira ndërkombëtare.

# V.HISTORIKU I PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË PUKË



Korrupsioni përbën një ndër sfidat më të qëndrueshme për funksionimin e qeverisjes demokratike, zhvillimin e qëndrueshëm dhe konsolidimin e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike. Si një fenomen kompleks dhe në evolucion të vazhdueshëm, ai përshtatet me shpejtësi ndaj ndryshimeve ligjore, teknologjike dhe organizative. Në këtë kontekst, adresimi efektiv i korrupsionit kërkon një qasje sistematike, afatgjatë dhe konsekuente, të mbështetur në forcimin e integritetit institucional, rritjen e transparencës dhe garantimin e llogaridhënies, veçanërisht në sektorët me nivel më të lartë ekspozimi ndaj riskut.

Integriteti institucional dhe parandalimi i korrupsionit përbëjnë një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare dhe një element thelbësor të reformës së qeverisjes publike, si në nivel qendror ashtu edhe vendor. Në kontekstin e sektorit publik, integriteti lidhet me përmbushjen e parimeve të transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe eficiencës në ushtrimin e funksioneve administrative dhe rregullatore, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve publike.

Në nivelin e qeverisjes vendore, politikat kundër korrupsionit dhe mekanizmat e menaxhimit të integritetit janë konkretizuar përmes zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015–2023, e cila vijon me Strategjinë 2024–2030 dhe Planin e Veprimit 2024–2026, të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 859, datë 26.12.2024. Paralelisht, këto nisma janë në përputhje me Strategjinë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030 (SNDQV), në veçanti me Objektivin Specifik 5.2, që synon nxitjen e politikave kundër korrupsionit dhe konsolidimin e integritetit në nivel vendor, miratuar me VKM nr. 252, datë 21.04.2023.

Në këtë kuadër strategjik dhe ligjor, menaxhimi i riskut të integritetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore përfaqëson një proces thelbësor për parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e qeverisjes vendore. Ky proces mbështetet në qëllimin e parandalimit të korrupsionit dhe konkretizohet përmes forcimit të mekanizmave të integritetit në administratën vendore, në përputhje edhe me rekomandimet e Komisionit Evropian për Shqipërinë në kuadër të procesit të integritetit evropian, të cilat theksojnë nevojën për krijimin dhe funksionimin e sistemeve efektive të menaxhimit të integritetit në institucionet publike.

[1] <https://bashkiapuke.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/Projekt-Vendim-04-date-29.06.2022-Plani-i-integritetit-.pdf>



Plani i Integritetit (PI) në vetvete është konceptuar si një dokument strategjik dhe operativ, i ndërtuar mbi një vlerësim të strukturuar të risqeve të integritetit në proceset kryesore të punës së administratës bashkiake. Vlerësimi është fokusuar në disa fusha prioritare të veprimtarisë institucionale, përfshirë menaxhimin financiar, administrimin e burimeve njerëzore, sistemet e kontrollit dhe auditimit, mekanizmat kundër korrupsionit, ofrimin e shërbimeve publike, administrimin dhe menaxhimin e pronave publike, planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe administrimin e dokumentacionit dhe informacionit, përfshirë dokumentet elektronike. Për identifikimin dhe analizimin e cenueshmërive të integritetit është përdorur një qasje metodologjike e kombinuar, që ndërthur metodat cilësore dhe sasore.

Duke marrë parasysh zhvillimet e deritanishme, vizioni i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2024-2030<sup>[1]</sup> konsiston në: “Institucione publike që ushtrojnë funksionet në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike dhe ofrojnë shërbime efçente ndaj qytetarëve”. Ndër objektivat e kësaj strategjie dhe që lidhet me objektin e këtij raporti monitorimi është objektivi specifik 1.2 “Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e Qeverisjes”. Dhe një nga format e arritjes së këtij objektivi është hartimi dhe zbatimi i planeve të integritetit. Transparenca e institucioneve publike, në të gjitha nivelet e Qeverisjes, përbën bazën për monitorimin e punës së tyre. Llogaridhënia e autoriteteve publike parandalon abuzimin e pushtetit, teksa kryerja e veprimtarisë institucionale me integritet dhe në përputhje të plotë me kuadrin rregullator në fuqi parandalon sjelljet joetike. Për këtë arsye, këto elementë kanë një rol thelbësor në parandalimin e korrupsionit gjatë ushtrimit të veprimtarisë shtetërore.

Përveç sa më lart, një aspekt i rëndësishëm tek i cili vë theksin edhe Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2024-2030 është edhe përfshirja e qytetarëve në luftën kundër korrupsionit. Kjo strategji, Objektivin Specifik 3.3 ia kushton pikërisht përfshirjes së të gjithë shoqërisë veçanërisht sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile dhe akademisë në luftën kundër korrupsionit. Në tërësi, procesi i hartimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë është zhvilluar mbi një qasje gjithëpërfshirëse dhe sistematike, e orientuar drejt parandalimit të risqeve, rritjes së transparencës dhe forcimit të integritetit institucional. Ky proces ka krijuar baza të qëndrueshme për zbatimin efektiv, monitorimin dhe raportimin periodik të Planit të Integritetit, si pjesë integrale e menaxhimit të riskut në nivel bashkie dhe e përmirësimit të vazhdueshëm të qeverisjes vendore.

Monitorimi dhe raportimi i Planit të Integritetit përbëjnë fazën pasuese të këtij procesi dhe realizohen në mënyrë periodike, zakonisht në baza vjetore, përmes angazhimit të strukturave drejtuese dhe stafit të Bashkisë Pukë, në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara për zbatimin e masave të miratuara në funksion të trajtimit dhe reduktimit të risqeve të integritetit.

---

<sup>[1]</sup> Strategjisa Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2024-2030

# VI.FAZA E ZBATIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT SIPAS OBJEKTIVAVE DHE PRIORITETEVE



Plani i Integritetit i Bashkisë Pukë strukturohet rreth tre objektivave specifike, të cilët synojnë forcimin e integritetit institucional dhe përmirësimin e qeverisjes vendore.

**Objektivi specifik 1-** konsiston në përmirësimin e kuadrit rregullator të Bashkisë në lidhje me aspektet e etikës dhe integritetit, përmes rishikimit dhe përditësimit të akteve të brendshme në përputhje me legjislacionin në fuqi, veçanërisht në fushat që lidhen me konfliktin e interesit, sinjalizimin, të drejtën për informim dhe standardet etike. Ky objektivi synon gjithashtu qartësimin e funksioneve dhe përgjegjësisë të njësive organizative, reflektimin e ndryshimeve strukturore dhe rritjen e ndërgjegjësimin të stafit mbi rregullat e integritetit, si bazë për ndërtimin e një administrate profesionale dhe të aftë për të menaxhuar shkeljet e integritetit dhe dilemat etike.

**Objektivi specifik 2-** fokusohet në menaxhimin efektiv të riskut të integritetit në fushat kryesore të përgjegjësisë së Bashkisë Pukë, përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore, shërbimeve publike, pronës bashkiake, financave dhe planifikimit të territorit. Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve është kryer mbi bazën e proceseve dhe nënprocese kryesore të punës, duke evidentuar problematika të lidhura me paqartësi procedurale, mangësi normative, kapacitete të kufizuara njerëzore dhe teknike, mbingarkesë në punë, bashkëpunim të pamjaftueshëm ndërmjet strukturave dhe infrastrukturë të kufizuar. Ky objektivi synon adresimin sistematik të këtyre risqeve përmes masave parandaluese dhe përmirësuese, me qëllim reduktimin e cenueshmërive ndaj shkeljeve të integritetit.

**Objektivi specifik 3-**ka në fokus përmirësimin e menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjitha nivelet dhe funksionet e Bashkisë, si një element kyç për konsolidimin e mekanizmave që garantojnë dhe mbrojnë integritetin institucional. Përmes forcimit të proceseve të rekrutimit, vlerësimit të performancës, trajnimit dhe zhvillimit profesional, synohet sigurimi i kapaciteteve të nevojshme administrative dhe zbatimi i standardeve të larta etike dhe profesionale. Realizimi i këtij objektiivi pritet të kontribuojë në rritjen e besimit të publikut, përmirësimin e imazhit institucional dhe ofrimin e shërbimeve publike cilësore në nivel vendor.

Në kuadër të tre objektivave të sipërcituara të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë të miratuar nga Këshilli Bashkiak për periudhën 2022–2025, janë përcaktuar një sërë aktivitete për zbatim, të kategorizuara sipas nivelit të prioritetit në prioritet të larta dhe prioritet mesatare. Bazuar në monitorimin e zbatimit të këtij plani, të realizuar nga Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) për vitet 2023 dhe 2024, rezulton se një pjesë e konsiderueshme e masave të parashikuara janë përmbushur, siç paraqitet në tabelat e mëposhtme. Këto të dhëna janë analizuar dhe përpunuar në mënyrë të detajuar, me qëllim vlerësimin e progresit të arritur dhe evidentimin e fushave që kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.



	Masat	Aktivitetet	2023	2024	Përbushja
<b>Objektivi I: "Përmirësimi i kuartrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave funksionale të bashkisë."</b>	<b>Prioritetet e Larta</b>	1. Hartimi dhe miratimi i Kodit të Sjelljes për institucionin.			Vazhdues
		2. Informimi dhe shpërndarja e Kodit tek punonjësit. Publikimi i Kodit në Programin e Transparencës.			Vazhdues
		3. Aplikimi i detyrimit të nënshkrimit të Kodit të Sjelljes çdo vit dhe depozitimi i këtij nënshkrimi pranë Burimeve Njerëzore.			Vazhdues
		4. Trajnime të brendshme në lidhje me rritjen e njohurive të punonjësve rreth Kodit të Sjelljes së Bashkisë.			Vazhdues
		5. Hartimi dhe miratimi i dispozitave të plota rregullatore për parandalimin e konfliktit të interesit për anëtarët e Këshillit Bashkiak.			Vazhdues
		6. Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës për Audituesin e Brendshëm.			Vazhdues
		7. Hartimi dhe miratimi i Deklaratës së Auditit të Brendshëm			Vazhdues
		8. Hartimi dhe miratimi i Strategjisë së Administrimit të Pronave Bashkiake.			Vazhdues
		9. Publikimi i strategjisë në Programin e Transparencës.			Vazhdues



	Masat	Akivitetet	2023	2024	Përmbushja
<b>Objektivi I: "Përmirësimi i kuadrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave funksionale të bashkisë."</b>	<b>Prioritetet Mesatare</b>	1. Hartimi i rregullave të brendshme për përgatitjen e Paketës së Taksave dhe Tarifave Vendore në bashki.		Realizuar	
		2. Informimi i personelit të të gjithë drejtorive mbi këto rregulla dhe Publikimi i tyre në Programin e Transparencës.		Realizuar	
		3. Hartimi i një PSV-je për përgatitjen e Termave të Referencës për prokurimet publike dhe Informimi i punonjësve të Bashkisë Pukë për përmbajtjen e PSV-së.			Vazhdues
		4. Hartimi dhe Miratimi i PSV-së për rekrutimin dhe promovimin e burimeve njerëzore dhe publikimin e ketyre procedurave në faqen zyrtare të Bashkisë.			Vazhdues
		5. Koordinimi me DAP-in për shpalljen e kërkesave për rekrutim.			Vazhdues
		6. Hartimi i një dokumenti të brendshëm politikash për mbrojtjen e të dhënave personale.			Vazhdues
		7. Informimi i personelit të të gjithë drejtorive mbi këtë dokument të miratuar.			Vazhdues
		8. Publikimi i këtij dokumenti në faqen zyrtare të Bashkisë për njohje dhe transparencë me publikun.			Vazhdues



	Masat	Akivitetet	2023	2024	Përmbushja
<b>Objektivi I: "Përmirësimi i kuartrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave funksionale të bashkisë."</b>	<b>Prioritetet Mesatare</b>	9.Hartimi dhe miratimi i një Plani Vjetor për Trajnimet e Brendshme, bazuar në nevojat e punonjësve dhe Informimi i stafit të bashkisë mbi këtë plan.			Vazhdues
		10.Parashikimi në Rregulloren e Brendshme e detyrimit të bashkisë për ndarjen e raportit të Auditimit të brendshëm me strukturat e bashkisë dhe informimi i stafit për këte detyrim.			Vazhdues
		11.Vendosja e kriterëve të paracaktuara dhe të matshme lidhur me performancën e instrumentit të zgjedhur të shërbimit publik.	Realizuar		
		12. Hartimi i PSV-së për hartimin dhe menaxhimin e kontratave publike dhe informimi i stafit të bashkisë për përmbajtjen e PSV-së.			Vazhdues
		13.Hartimi i planit të përdorimit të pronave në bazë të marrëdhënieve kontaktuale dhe të përfshihet si kapitull i veçantë në Strategjinë e Administrimit të Pronave Bashkiake.			Realizuar
		14.Hartimi dhe miratimi i rregullave të brendshme mbi mënyrat e trajtimit të ankesave dhe kërkesave të qytetarëve në lidhje me pronat bashkiake. Informimi i personelit të Bashkisë dhe publikimi i rregullave në programin e Transparences.			



	Masat	Akivitetet	2023	2024	Përmbushja
<b>Objektivi I: "Përmirësimi i kuadrit rregullator të bashkisë mbi aspekte të etikës dhe integritetit sipas fushave funksionale të bashkisë."</b>	<b>Prioritetet Mesatare</b>	15 .Hartimi i një PSV-je për proceset e punës që administrojnë Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit Vendor në Bashki, Informim dhe publikim në Programin e Transparencës.	Realizuar		
		16.Hartimi, miratimi dhe publikimi i Raportit Vjetor të Transparencës.		Realizuar	
		17.Krijimi regjistri për KI-në, të plotësohet dhe të raportohet rast pas rasti dhe informimi i personelit lidhur me detyrimet përkatëse.	Realizuar	Realizuar	
		18.Realizimi i monitorimeve periodike të performancës dhe kryerja e një analize mbi këtë proces dhe informimi i titullarit mbi këtë analizë.			Vazhdues



	Masat	Akivitetet	2023	2024	Përmbushja
<b>Objektivi II: "Menaxhim efektiv i riskut të integritetit me fokus fushat e përgjegjësisë së bashkisë"</b>	<b>Prioritetet e Larta</b>	1.Rishikimi i metodave të planifikimit buxhetor për zërin e të ardhurave për të pasur një parashikim realist.	Realizuar		
		2.Sigurim i një baze të plotë e të dhënave të nevojshme dhe sistemi i kontrollit përkatës.	Realizuar		
		3.Asistencë trajnuese për burimet njerëzore të përfshira në proces.	Realizuar		
		4. Plan Pune nga ana e Bashkisë për realizimin e të ardhurave të parashikuara.	Realizuar		
		5. Miratimi dhe Publikimi i Kartës së Auditimit.			Vazhdues
		6. Identifikimi i njësive të varësisë që nuk kanë gjurmueshmëri të informacionit.			Vazhdues
		7. Krijimi i rrjedhës së proceseve të punës së njësive, ku të identifikohet qartësisht ndarja e punës dhe përgjegjësisë.			Vazhdues
		8. Parashikimi në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë i detyrimeve të njësive të bashkisë në lidhje me gjurmueshmërinë e informacionit.		Realizuar	



	Masat	Akivitetet	2023	2024	Përbushja	
<b>Objektivi II: "Menaxhim efektiv i riskut të integritetit me fokus fushat e përgjegjësisë së bashkisë"</b>	<b>Prioritetet e Larta</b>	9.Vlerësimi nevojave aktuale për burime njerëzore shtesë dhe kapacitete teknike në Sektorin e Menaxhimit të Pronave. 9.1 Paraqitja e vlerësimit Kryetarit të Bashkisë.			Vazhdues	
		10. Evidentimi i pronave bashkiake të paazhurnuara dhe të krijohet një listë prioritare e tyre.		Realizuar		
		11.Realizimi i azhornimeve të nevojshme të dokumentacionit teknik duke marrë parasysh prioritetet e përcaktuara.				Vazhdues
		12.Hartimi i një plani pune për inventarizimin e pronave të azhurnuara				Vazhdues
		13. Ngritje e një grupi pune me punonjës të bashkisë, për të përshpejtuar mbarëvajtjen e procesit të inventarizimit në mbështetje të planit të punës.				Vazhdues
		14.Hartimi, konsultimi dhe miratimi i Planeve të Detajuara Vendore për zonat që paraqesin vizion dhe mundësi zhvillimi duke i përshtatur me vizionin e përgjithshëm të PPV-së.				Vazhdues



	Masat	Akivitetet	2023	2024	Përmbushja
<b>Objektivi II: "Menaxhim efektiv i riskut të integritetit me fokus fushat e përgjegjësisë së bashkisë"</b>	<b>Prioritetet e Larta</b>	15. Vlerësimi i situatës aktuale dhe nevojave për sa i përket burimeve njerëzore dhe kapaciteteve teknike për ngritjen dhe funksionimin e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit dhe dorëzimi I vlerësimit tek titullari.			Vazhdues
		16. Finalizimi i digjitalizimit të Fondit Arkivor.			Vazhdues
	<b>Prioritetet Mesatare</b>	1. Parashikimi i rregullave të qarta për ndryshimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik në rastet e emergjencave.	Realizuar		
		2. Krijimi i Planit të vijueshmërisë për rastet e emergjencave, si referencë për ndryshimet që mund të ndodhin në regjistrin e parashikimit të prokurimeve.	Realizuar		
		3. Shoqërimi me dokumentacionin e nevojshëm të çdo ndryshimi që pëson grafiku i prokurimeve dhe vendimmarrja e dakorduar nga Këshilli Bashkiak /Kryetari.	Realizuar		
		4. Publikimi i Strategjisë për menaxhimin e riskut në Programin e Transparencës.			-



	Masat	Akivitetet	2023	2024	Përmbushja
<b>Objektivi II: "Menaxhim efektiv i riskut të integritetit me fokus fushat e përgjegjësisë së bashkisë"</b>	<b>Prioritetet Mesatare</b>	5. Rishikimi i metodologjisë së planifikimit të financimit të shërbimeve bazë për garantimin e qëndrueshmërisë së tyre.	Realizuar		
		6. Vlerësimi i situatës së kapaciteteve teknike në funksion të shërbimeve të kryera nga bashkia duke kryer edhe prioritizimin e nevojave.	Realizuar		
		7. Sigurimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve aktuale.			Vazhdues
		8. Alokimi i burimeve të nevojshme për rekrutimin e burimeve njerëzore më të domosdoshme.			Vazhdues
		9. Alokimi i burimeve financiare në buxhet, sipas listës së prioriteteve të Bashkisë për përfitim të certifikatave të pronësisë së pronave bashkiake.			Vazhdues
		10. Digjitalizimi i pronave bashkiake të azhuruara dhe të inventarizuara.			Vazhdues
		11. Publikimi në Programin e Transparencës i informacionit lidhur me pronat e kategorive të ndryshme dhe statusin e tyre për t'u vënë në dispozicion të palëve të interesuara.			Realizuar



	Masat	Akivitetet	2023	2024	Përmbushja
<b>Objektivi II: "Menaxhim efektiv i riskut të integritetit me fokus fushat e përgjegjësisë së bashkisë"</b>	<b>Prioritetet Mesatare</b>	12. Nxitja e pjesëmarrjes së grupeve të interesit dhe qytetarëve në proceset e konsultimit nëpërmjet organizimit të aktiviteteve informuese dhe atyre orientuese rreth përfitimeve të pjesëmarrjes në dëgjesat publike.			Vazhdues
		13. Publikimi në Programin e Transparencës, në Zyrën e Shërbimit me një Ndalesë dhe në këndet e informacionit të njësisë administrative, të shërbimeve që ofron Zyra e Urbanistikës së Bashkisë: dhënies së lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit dhe certifikatës së përdorimit.			Vazhdues
		14. Rishikim i ndarjes aktuale të detyrave, mbështetur në vlerësimin e situatës së burimeve njerëzore, për cdo pozicion pune në këtë drejtori.			Vazhdues
		15. Kryerja e një vlerësimi mbi nevojën për të kategorizuar Fondin Arkivor si njësi më vete. 1 Informimi i Kryetarit të Bashkisë në lidhje me këtë vlerësim.			Vazhdues
		16. Finalizimi i procesit të inventarizimit dhe krijimit të dosjeve përkatëse sipas kërkesave të Ligjit të Arkivave.			Vazhdues
		17. Pajisja e rrjetit kompjuterik për arkivën dhe protokollin e bashkisë me një sistem back-up për garantimin e sigurisë së informacionit të digjitalizuar.			Vazhdues



	Masat	Akivitetet	2023	2024	Përmbushja
<b>Objektivi III: "Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në gjitha nivelet dhe funksionet në bashki."</b>	<b>Prioritetet e Larta</b>	1. Analizë e nevojave aktuale dhe vlerësim i shtimit të burimeve njerëzore të kualifikuara në DFBNE. 2. Përfshirja e moduleve të trajnimit për PBA-në në Planin Vjetor të Trajnimeve të Brendshme.			Vazhdues
		2. Trajnime periodike të punonjësve të bashkisë rreth ligjit "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" dhe rregullores përkatëse.		Realizuar	
		3. Trajnime të punonjësve të bashkisë rreth ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike" dhe zbatimin efektiv të tij dhe të rregullores përkatëse. 2. Publikim i rregullores "Për parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike" në Programin e Transparencës së Bashkisë.		Realizuar	
		4. Trajnime të brendshme për rritjen e njohurive të punonjësve dhe drejtuesve të bashkisë rreth trajtimit të shkeljeve të etikës dhe masave përkatëse disiplinore, në përputhje me Kodin e Sjelljes së Bashkisë.		Realizuar	



	Masat	Akivitetet	2023	2024	Përmbushja
<b>Objektivi III: "Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në gjitha nivelet dhe funksionet në bashki."</b>	<b>Prioritetet e Larta</b>	5.Vlerësimi situatës aktuale të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve teknike në Bashkinë Pukë. Planifikim i burimeve të domosdoshme për realizimin optimal të objektivave në përputhje me rezultatet e analizës së vlerësimit të situatës. Plan për rekrutimin e kapaciteteve teknike më të domosdoshme sipas detyrave funksionale.	Realizuar		
		6.Plotësimi i njësisë së auditit të brendshëm me burimet njerëzore të nevojshme për kryerjen e funksionit të saj.	-	-	-
	<b>Prioritetet e Mesatare</b>	1. Trajnimi i personelit të sektorit të prokurimeve publike rreth legjislacionit mbi prokurimet publike.	Realizuar		
		2.Trajnime të brendshme për rritjen e njohurive të drejtuesve dhe punonjësve të bashkisë lidhur me pranimin dhe administrimin e dhuratave.	-	-	-
		3. Rishikimi i formularit të vlerësimit të performancës në punë duke shtuar një rubrikë fakultative për vlerësimin e detyrave shtesë të ushtruara nga personeli, si pjesë e procesit të menaxhimit të performancës.Detajimi i rubrikës "detyra të tjera" në përshkrimet e punës për cdo pozicion në bashki, si të lidhura me detyrat parësore.	Realizuar		



	Masat	Akivitetet	2023	2024	Përbushja
<b>Objektivi III: "Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në gjitha nivelet dhe funksionet në bashki."</b>	<b>Prioritetet e Mesatare</b>	4. Sigurimi i kushteve dhe mjediseve të përshtatshme për ruajtjen e dosjeve fizike që përmbajnë të dhëna personale të punonjësve.	-	-	-
		5. Emërimi i një personi të dedikuar për detyrën e Koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.	Realizuar		
		6. Krijimi i bazës rregullatore përkatëse në lidhje me procedurat për grumbullimin, përpunimin dhe rrjedhën e informacionit nga sektorët funksionalë të Zyra e Shërbimit me një ndalesë. Informimi i punonjësve të bashkisë në lidhje me këto rregulla. Përmirësimi i rrjetit digjital për transferimin e informacionit të brendshëm që furnizon Zyrën e Shërbimit me një Ndalesë.	Realizuar		
		7. Publikimi online, si edhe në këndet e informacionit të Bashkisë Pukë dhe të njësisë administrative, të shërbimeve që ofron Zyra e Shërbimit me një Ndalesë.			Vazhdues
		8. Realizimi i trajnimeve të brendshme për stafin përgjegjës në lidhje me hartimin dhe menaxhimin e kontratave publike.			Vazhdues
		9. Alokimi i burimeve të nevojshme dhe realizimi i procedurave për rekrutimin e një specialisti topograf me arsim të lartë.			Vazhdues



	Masat	Aktivitetet	2023	2024	Përbushja
<b>Objektivi III: "Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në gjitha nivelet dhe funksionet në bashki."</b>	<b>Prioritetet e Mesatare</b>	10.Vlerësim i situatës aktuale të burimeve njerëzore dhe kapaciteteve teknike në Drejtorinë e Urbanistikës, 2.Plan për rekrutimin e kapaciteteve teknike sipas detyrave funksionale. 3.Planifikim i burimeve të domosdoshme për realizimin optimal të objektivave në përputhje me rezultatet e analizës së vlerësimit të situatës. 4.Të planifikohen trajnimet e nevojshme të brendshme për stafin teknik në Drejtorinë e Urbanistikës.	Realizuar		
		11.Mbështetur në vlerësimin e situatës së burimeve njerëzore, të parashikohen në buxhet burimet e domosdoshme për mundësimin e trajnimeve me pagesë nga ASPA për stafin, subjekt i Kodit të Punës.			Vazhdues
		12. Digjitalizimi i dosjeve të personelit dhe aplikantëve në proceset e rekrutimit në bashki.Garantimi i aksesit të rezervuar për personat e caktuar për administrimin e dosjeve.			Vazhdues
		13.Ngritja e Komitetit të Përhershëm i Pranimit.			Vazhdues
		14.Organizimi i takimeve informuese nga SBNJ-ja, për menaxhimin e burimeve njerëzore me fokus vlerësimin e performancës së stafit. 2. Përcaktimi në Rregulloren e Brendshme i detyrimit për kryerjen e Analizës Vjetore të Performancës.			Realizuar



Në analizë të të dhënave tabelare të cituara më sipër, kolona 2023 në të cilin është mbajtur shënimi realizuar nënkupton se masat e parashikuara në planin e integritetit janë përmbushur sipas objektivave përkatëse pikërisht në këtë vit. E njëjta logjikë praktike është përdorur edhe për vitin 2024. Ndërkohë sa i takon shtyllës së tretë, ajo nënkupton që aktivitetet e parashikuara sipas planit të integritetit janë ende në proces zbatimi, në përputhje me afatin e ri të shtyrjes së zbatueshmërisë së planit të integritetit deri në gusht të 2026. Në seksionet ku është vendosur shenja (-), nënkupton se nuk është arritur identifikimi i qartë i fazës së zbatimit.

Nga tentativa për të identifikuar rast pas rasti aktet e ndërmarra apo aktivitetet e raportuara si të realizuara në faqen zyrtare, rezulton se nuk mund të identifikohen lehtësisht me një kërkim të thjeshtë. Edhe nga realizimi i kërkimit të avancuar nuk rezulton që të jenë të gjitha masat e publikuara. **Në këtë kontekst është e rekomandueshme që të ndërmerren hapa proaktivë për publikuar në një seksion të veçantë periodicitetin e zbatueshmërisë së planit të integritetit me qëllim përcjelljen e informacionit në kohë reale dhe lehtësisht të asimilueshëm për publikun.**

## VII. VËSHTRIM KRAHASIMOR PËRMBUSHJES SË OBJEKTIVAVE TË PI NDËRMJET VITEVE



Përveç mekanizmave të pavarur të vlerësimit të zbatimit të Planeve të Integritetit, kuadri ligjor parashikon edhe ekzistencën e një autoriteti publik me kompetenca të drejtpërdrejta kontrolli dhe mbikëqyrjeje mbi procesin e zbatimit të tyre. Në këtë kontekst, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) ushtron një rol kyç në bashkërendimin, orientimin dhe monitorimin e proceseve të hartimit, zbatimit dhe vlerësimit të Planeve të Integritetit në nivel vendor. Misioni i AMVV-së konsiston në ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme institucionale dhe teknike për njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim garantimin e përmbushjes me efektivitet dhe efikasitet të përgjegjësisve ligjore që u ngarkohen në fushën e integritetit, transparencës dhe llogaridhënies. Në kuadër të këtij misioni, AMVV ka ofruar asistencë teknike për hartimin e Planeve të Integritetit në 35 bashki në nivel kombëtar, konkretisht: 5 plane në vitin 2019, 1 plan në vitin 2021, 14 plane në vitin 2022, 3 plane në vitin 2023 dhe 12 plane në vitin 2024. Në vijim të këtij angazhimi, Agjencia ka përfunduar gjithashtu procesin e monitorimit të zbatimit për 17 Plane Integriteti gjatë vitit 2024. Të dhënat e përgjithshme të përfutuara nga procesi i monitorimit tregojnë se, në rang kombëtar, planet e veprimit të Planeve të Integritetit janë realizuar mesatarisht në nivelin 59%, duke reflektuar një progres të qëndrueshëm, por edhe nevojën për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve institucionale dhe mekanizmave të zbatimit në nivel vendor.

Në kuadër të programit të miratuar për monitorimin periodik të nivelit të zbatimit të Planeve të Integritetit, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) ka realizuar dy procese monitorimi të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë. Raporti i monitorimit për vitin 2023 ka evidentuar në mënyrë të përmbledhur se: ‘Bashkia Pukë ka vijuar me zbatimin e planit të Integritetit duke realizuar një nivel të mirë të realizimit të masave /aktiviteteve në 62 % të realizimit të masave të planifikuara për integritetin (61-80) për vitin 2023, për sa i përket realizimit të objektivave ka arritur një nivel shumë të mirë realizimi në objektivin e tretë të menaxhimit të burimeve njerëzore 80% ( 61-80) % duke sjellë një impakt pozitiv në përmirësimin e rritjes të trajnimeve dhe ndërgjegjësimin dhe edukimit të punonjësve ku ndërgjegjësimi dhe edukimi i tyre rreth rreziqeve të korrupsionit dhe rëndësisë së veprimit etik janë të rëndësishme për suksesin e planit të integritetit.’<sup>[3]</sup>

Ndërkohë që nga monitorimi i kryer nga AMVV për vitin 2024, ka rezultuar se: ‘Në përmblyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese janar-dhjetor 2024, bazuar në gjetjet që ky dokument ofron, të dhënat analitike të raportuara nga drejtoritë përkatëse dhe analizën e kryer, rezulton se: Bashkia Pukë ka vijuar me zbatimin e Planit të Integritetit, duke arritur një nivel bazik realizimi prej 50% të masave të planifikuara për vitin 2024 (në intervalin 40-60%).

[3] <https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Bashkia-Puke.docx>



Gjatë kësaj periudhe janë arritur rezultate pozitive në:

- *Ngritjen e kulturës së integritetit dhe llogaridhënies në bashki;*
- *Transparencë më e lartë në publikimin e informacioneve;*
- *Trajnime dhe aktivitete që mbështesin etiken institucionale;*

Masat dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të zbatimit të Planit të Integritetit kanë ndikuar ndjeshëm në rritjen e shkallës së integritetit të institucionit. Si rezultat, një sërë dokumentesh strategjike, aspekte të punës dhe të shërbimeve të ofruara, rezultatet e kontrolleve financiare, si dhe instrumentet për raportimin e korrupsionit apo shkeljeve të tjera, janë bërë të aksesueshme në adresën zyrtare të bashkisë. Ky progres ka ndikuar në rritjen e shkallës së integritetit të bashkisë Pukë.<sup>[4]</sup>

Krahasimisht, nga vështrimi kritik i të dy raporteve vërehet se viti 2023 karakterizohet nga një nivel më i lartë realizimi sasior të masave, me fokus të theksuar në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit.

Ndërkohë viti 2024, ndonëse me një nivel më të ulët përqindjeje realizimi, shënon konsolidim cilësor të rezultateve, veçanërisht në drejtim të transparencës, aksesit në informacion dhe forcimit të kulturës së integritetit. Kjo ecuri është dëshmi e qartë se Bashkia Pukë ka vijuar procesin e zbatimit të Planit të Integritetit në mënyrë progresive, duke kaluar gradualisht nga një fazë me theks në realizimin e masave dhe ndërgjegjësimin e stafit, drejt **një faze konsolidimi dhe institucionalizimi të praktikave të integritetit dhe transparencës.**

---

[4] Raport mbi Monitorimin e Planeve të Integritetit – Bashkia Pukë

# VIII. TRANSPARENCA NË FAQEN ZYRTARE TË BASHKISË PUKË DHE AKSESI NË INFORMACION



Në terma të përgjithshëm, transparenca është një nga parimet kryesore që duhet të karakterizojë secilin nga organet publike përgjatë ushtrimit të funksionit të tyre. Megjithatë në një kuptim më të ngushtë dhe konkret, detyrimi i organeve publike për të qenë sa më ta hapur dhe transparent me publikun është materializuar në “Programi i Transparencës” i cili ngrihet dhe funksionon sipas Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, i ndryshuar, që synon garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik dhe vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion. Në vitin 2023, ky program është standartizuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe përshtatur sipas kategorisë së autoriteteve publike.

Në të njëjtën formë qëndron edhe detyrimi i institucioneve publike pëfshirë edhe ato të vetëqeverisjes vendore për të ndërtuar një program transparence i cili të garantojë njohjen maksimale me informacionin publik si dhe të vërë në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion, buron nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

Në përmbushje të këtij detyrimi, vërehet se Bashkia Pukë, ka të publikuar në faqen e saj zyrtare, programin e transparencës i cili i përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara sipas ligjit.[5] Gjithashtu, nga një monitorim i detajuar i faqes zyrtare, rezulton se niveli i informimit të vizitorëve të faqes shkon përtej përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga programi i transparencës, pasi vërehet se gjenden të publikuara në mënyrë periodike të gjitha informacionet që lidhen me vendimmarrjet e Këshillit Bashkiak, çështjet që lidhen me buxhetin, rekrutimet, projektet në zbatim, shërbimet publike, planet vendore, afishimet publike etj.



[5] <https://bashkiapuke.gov.al/programi-transparences/>

Ekzistenca e transparencës nga organet e vetëqeverisjes vendore në përputhje me ligjin, e bën institucionin më të hapur dhe llogaridhënës duke i dhënë mundësinë cdo qytetari që të informohet në kohë reale për të gjithë veprimtarinë e Bashkisë Pukë.

Megjithatë, duke marrë parasysh përgjigjet e dhëna nga një pjesë e qytetarëve, rezulton se jo të gjithë mund të jenë të njohur me të dhenat e publikuara nga Bashkia Pukë. Kjo situatë tregon nevojën për realizimin e sesioneve informuese dhe ndërgjegjësuese të qytetarëve në mënyrë të të dhënat që ofrohen nga Bashkia të jenë të njohura, të përdorshme dhe mbi të gjitha qytetarët të kenë mundësinë që ta ushtrojnë sovranitetin e tyre përmes mekanizmave të përfshirjes dhe të kontrollit që kanë në dispozicion.

# VIII.QASJA VETËVLERËSUSE E BASHKISË PUKË NË PËRMBUSHJEN E PLANIT TË INTEGRITETIT DHE ZGJATJA E AFATIT



Për të pasur një panoramë më të qartë të fazës së zbatimit të planit të integritetit në një rend kronologjik dhe të gjithanshëm, Together for Life, ka përcjellë pranë Bashkisë Pukë, kërkesën nr. 1/2026 datë 13.01.2026 me objekt: “Vënien në dispozicion të informacionit që lidhet me planin e integritetit dhe fazën e zbatimit të tij.” Në këtë shkresë, fondi i pyetjeve të drejtuara Bashkisë, ka konsistuar në mënyrë të përmbledhur në kërkimin e informacionit mbi hapat konkretë të ndërmarrë në zbatim të planit të integritetit për periudhën kohore 2024-2025, për përmbushjen e 3 objektivave madhorë të përcaktuara në planin e integritetit; mbi faktin nëse Bashkia Pukë ka një plan apo mekanizem të strukturuar të përfshirjes së qytetarëve në zbatimin e Planit të Integritetit, dhe rastet e përfshirjes së opinionëve të publikut në zbatimin e planeve të Bashkisë Pukë. Një aspekt i rëndësishëm është edhe informacioni lidhur me vështirësitë apo mangësitë që kanë dalë në pah gjatë procesit të zbatimit të Planit të Integritetit si dhe format e adresimit të tyre nga ana e Bashkisë.

Në shkresën kthim-përgjigje Nr. 112 Prot. datë 19.01.2026 Bashkia Pukë, është përgjigjur në mënyrë konkrete ndaj secilës pyetje duke përcaktuar në mënyrë të posacme se: lidhur me përmirësimin e kuadrit rregullator mbi etikën dhe integritetin Bashkia Pukë ka ndërmarrë rishikimin dhe përditësimin e akteve të brendshme rregullatore, përfshirë rregulloren e brendshme, kodin e etikës dhe procedurat administrative, me qëllim forcimin e standardeve të integritetit dhe etikës në të gjitha fushat funksionale të institucionit. Në këtë kuptim, Bashkia referon se janë identifikuar fushat me risk të shtuar të integritetit dhe janë marrë masa parandaluese përmes përmirësimit të procedurave të punës, forcimit të kontrollit të brendshëm dhe rritjes së transparencës në proceset vendimmarrëse dhe administrative. Në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore Bashkia referon se është punuar në drejtim të rritjes së kapaciteteve profesionale të stafit, përmes informimit dhe trajnimit mbi parimet e etikës, integritetit dhe përgjegjshmërisë institucionale, si dhe përmirësimit të praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Sa i takon përfshirjes qytetare mbi përfshirjen në procesin e zbatimit të planit të integritetit është referuar se: “Bashkia Pukë ka parashikuar mekanizma të përfshirjes së qytetarëve përmes konsultimeve publike, transparencës së informacionit dhe kanaleve të komunikimit me publikun, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Përfshirja e publikut është realizuar kryesisht në fazat e informimit dhe konsultimit, përmes publikimit të informacionit, komunikimit me qytetarët dhe marrjes së sugjerimeve në lidhje me çështje që lidhen me transparencën dhe shërbimet publike. Sugjerimet, ankesat dhe opinionet e qytetarëve janë marrë në konsideratë në rastet kur ato kanë qenë të argumentuara dhe të zbatueshme, duke u reflektuar në përmirësimin e procedurave dhe praktikave administrative, në funksion të rritjes së integritetit institucional.” Ndërkohë, lidhur me vështirësitë apo mangësitë e hasura në zbatimin e këtij plani janë referuar si të tilla, sfidat që lidhen kryesisht me kapacitetet njerëzore, nevojën për trajnime të vazhdueshme dhe konsolidimin e kulturës së integritetit në të gjitha nivelet e administratës vendore.

Megjithëse vështirësi të hasura, nga ana e Bashkisë është referuar se për adresimin e këtyre sfidave janë ndërmarrë masa për forcimin e kapaciteteve administrative, rritjen e ndërgjegjësimit të stafit, si dhe përmirësimin gradual të mekanizmave të monitorimit dhe zbatimit të Planit të Integritetit. Në vazhden e punës mbi zbatimin e planit të integritetit, Bashkia Pukë nëpërmjet vendimit Nr.07, datë 20.08.2025 “Për shtyrjen e afatit të zbatimit të planit të integritetit të bashkisë pukë 2022-2025 me një vit shtesë”<sup>[6]</sup> ka vendosur shtyrjen me 1 vit të afatit të zbatimit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë, nga viti 2025 deri në Gusht 2026.

Zgjatja e afatit të zbatimit të planit të integritetit është diktuar si një nevojë për përmbushjen e 3 objektivave madhorë: së pari, me qëllim për të realizuar në mënyrë të plotë disa masa të papërfunduara në planin aktual; së dyti, me qëllim përforcimin e mekanizmave të parandalimit të korrupsionit dhe rritjen e transparencës institucionale; dhe së treti, përgatitjen e një procesi gjithëpërfshirës dhe cilësor për hartimin e Planit të ri 2026- 2030. Sipas relacionit shpjegues Nr. 1433/1 prot. Datë 20.08.2025 lidhur me projekt-vendimin "Për shtyrjen e afatit të Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë 2022- 2025 me një vit tjetër" është arsyetuar se gjatë periudhës 2022–2025 janë realizuar një sërë masash konkrete në përputhje me planin, por disa veprime të rëndësishme kërkojnë më shumë kohë për përmbushje.

Shtyrja me një vit e këtij afati do të mundësojë finalizimin e masave të mbetura, vlerësimin e plotë të impaktit të deritanishëm dhe përgatitjen cilësore të Planit të ri të Integritetit për periudhën 2027–2030. Sipas relacionit shpjegues, kjo shtyrje përbën një veprim institucional të përgjegjshëm, në funksion të konsolidimit të etikës publike dhe përmbushjes së standardeve që kërkon shërbimi ndaj qytetarëve. Në fakt, kjo qasje dhe veprim i Bashkisë Pukë, vlerësohet si pozitive dhe e ndërmarrë në kushtet e një vetëvlerësimi objektiv dhe të përgjegjshëm, duke dëshmuar se ky proces nuk mbetet thjesht në nivel formal zbatueshëm, por shpreh angazhimin për përfshirje konkrete në zbatimin e planit dhe përmirësimin të situatës në Bashkinë Pukë.

---

<sup>6]</sup><https://bashkiapuke.gov.al/wp-content/uploads/2025/08/Projekt-vendim-Per-shtyrjen-me-nje-vit-te-planit-te-integritetit.pdf>

# IX. RËNDËSIA E PËRFSHIRJES QYTETARE EX ANTE DHE EX POST VENDIMARRJES SË PUSHTETIT VENDOR



Vendimmarrja e ndërtuar mbi konsultimin dhe angazhimin e qytetarëve fiton karakter substancial, pasi reflekton interesin publik dhe nevojat reale të komunitetit, duke respektuar parimin *salus populi suprema lex esto*. Kjo qasje kontribuon jo vetëm në rritjen e cilësisë së vendimeve, por edhe në forcimin e besimit reciprok ndërmjet qytetarëve dhe autoriteteve vendore.

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj përfshirjeje lidhet me ushtrimin e kontrollit qytetar mbi veprimtarinë e pushtetit vendor. Në këtë kontekst, matja e ecurisë së zbatimit të Planit të Integritetit në Bashkinë Pukë përbën një domosdoshmëri institucionale dhe demokratike. Arsyeja e kësaj matjeje lidhet drejtpërdrejt me detyrimin që pushteti vendor ka ndaj zbatimit të ligjit, si dhe ndaj mandatit dhe mocionit të dhënë nga qytetarët, të cilët janë burimi primar i legjitimitetit institucional (*ex consensu civium*). Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të këtij plani shërbejnë si instrument për garantimin e integritetit, parandalimin e korrupsionit dhe rritjen e transparencës administrative.

Po ashtu, një nga mënyrat më efektive të ushtrimit të këtij kontrolli nga qytetarët realizohet përmes pjesëmarrjes aktive në proceset propozuese dhe vendimmarrëse të pushtetit vendor. Kjo përfshirje i jep vendimmarrjes një karakter më subsidiar, në përputhje me parimin subsidiaritas, pasi problematikat dhe nevojat për përmirësim adresohen në nivelin më të afërt me qytetarin. Autoritetet publike, duke qenë më pranë komunitetit, krijojnë mundësinë për reagim të menjëhershëm dhe për gjetjen e zgjidhjeve më efikase dhe të përshtatura ndaj realitetit lokal. Gjithashtu, duhet theksuar se pjesëmarrja qytetare *ex ante*, pra përpara marrjes së vendimit nga pushteti vendor, ka të njëjtën peshë dhe rëndësi demokratike si pjesëmarrja e qytetarëve *ex post*, në cilësinë e monitoruesve të vendimmarrjes dhe të veprimtarisë së organeve të vetëqeverisjes vendore.

Përfshirja *ex ante* u jep qytetarëve mundësinë të ndikojnë në fazën propozuese dhe konceptuale të politikave publike, në përputhje me parimin *participatio civium*, ndërsa pjesëmarrja *ex post* siguron kontrollin, transparencën dhe llogaridhënien e autoriteteve publike në zbatimin e vendimeve, në frymën e *res publica*. Këto dy dimensione përbëjnë një proces të pandashëm dhe komplementar të demokracisë lokale, që forcon qeverisjen vendore dhe mbron interesin publik. Sakaq, pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen vendore nuk është vetëm një e drejtë demokratike, por edhe një detyrim qytetar dhe institucional. Ajo përfaqëson një kusht të domosdoshëm për ndërtimin e një qeverisjeje vendore të përgjegjshme, transparente dhe të orientuar drejt interesit publik, ku qytetari nuk është thjesht subjekt pasiv i politikave, por aktor aktiv në formësimin e tyre (*civis activus*).

# X. FORMAT AKTUALE TË MONITORIMIT TË PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË PUKË NË DISPOZICION TË QYTETARËVE



Qytetarët e Bashkisë Pukë, në të njëjtën mënyrë si qytetarët e çdo Bashkie tjetër, kanë në dispozicion një gamë të gjerë mekanizmash të garantuar nga legjislacioni shqiptar që u mundësojnë jo vetëm të informohen mbi veprimtarinë e institucioneve vendore, por edhe të marrin pjesë aktivisht në proceset e vendimmarrjes dhe vetëqeverisjes vendore. Kjo formë e cila do të përshkruhet më poshtë në këtë seksion përbën formën ex ante të pjesëmarrjes, që nënkupton formën e pjesëmarrjes dhe kopsnultimit përpara se vendimmarrja të jetë konkluduar nga pushteti vendor. Ndërsa, forma të tjera si monitorimet, referendumet, petitionet, ankesat zakonisht përdoren për të ndryshuar një vendimmarrje ekzistente konsiderohen si ndërhyrje ex post vendimmarrjes. Përdormi i të dy llojeve të instrumenteve synojnë të sigurojnë transparencë, llogaridhënie dhe përfshirje të gjerë të komunitetit, duke forcuar demokracinë pjesëmarrëse dhe rolin e qytetarëve në administrimin e çështjeve publike në nivel vendor.

Një nga mekanizmat themelorë është *e drejta për të kërkuar informacion publik*, e cila garantohet nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar. Përmes paraqitjes së kërkesave zyrtare pranë Bashkisë Pukë, çdo qytetar mund të pajiset me informacion publik dhe të njihet me dokumentet përkatëse për aq sa plotësohet kushtet e ligjit të sipërcituar dhe për aq sa legjitimohet nga natyra publike e informacionit. Sipas ligjit të sipërcituar, çdo institucion publik përfshirë këtu edhe institucionet e pushtetit vendor kanë detyrimin të përgjigjen brenda 10 ditëve pune nga e nesërmja e paraqitjes së kërkesës për informacion dhe nëse do të jetë rasti të justifikojë çdo refuzim në mënyrë të argumentuar dhe të bazuar në ligj. Ky instrument i jep qytetarëve mjetin kryesor për të monitoruar punën e administratës dhe për të kërkuar llogaridhënie për përdorimin e fondeve publike. Përveç qasjes në informacion, mbështetur në parashikimet ligjore por edhe në parashikimet e Nenit 38 të Rregullores së Këshillit Bashkiak “Mbi marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me publikun dhe median rregullon pjesëmarrjen e qytetarëve në mbledhjet e Këshillit Bashkiak”, *parashikohet e drejta e pjesëmarrjes dhe modalitetet e përfshirjes qytetare në mënyrë proaktive në mbledhjet e Këshillit Bashkiak*.

Sipas Rregullores, qytetarët janë të lirë të marrin pjesë në Mbledhjet e Këshillit sipas rregullave dhe procedurave ligjore dhe kësaj rregullore. Kur një qytetar dëshiron të marrë pjesë dhe të flasë në Mbledhjen e Këshillit, ai/ajo duhet të dorëzojë kërkesë me shkrim, të nënshkruar, me emrin, adresën e plotë dhe numrin e celularit, dhe ku duhet të specifikojë çështjen për të cilën do të flasë, së paku një ditë përpara mbajtjes së Mbledhjes, apo mund të dërgojë të dhënat e tij edhe në postën elektronike të Sekretarit. Në të dy rastet qytetari duhet të dorëzojë kërkesën me të dhënat sëpaku 48 orë para Mbledhjes.



Sa i takon kohës që qytetarët kanë në dispozicion për të relatuar përpara këshillit, rregullorja parashikon se qytetarët kanë tre (3) minuta kohë për t'iu drejtuar Këshillit në Mbledhjet e rregullta dhe sipas radhës së regjistrimit për të folur. Qytetarët kanë pesë (5) minuta për të folur si individ ose 8 minuta në emër të një organizate apo grupi interesi në rastet e seancave dëgjimore publike. Çdo anëtar i Këshillit ka deri në tre (3) minuta për të bërë pyetje qytetarit në mbledhjet e Këshillit të rregullt dhe të Komitetit të Përherëshëm dhe pesë minuta në Seancat Publike, në lidhje me propozimin, komentimin apo rekomandimin. Këshilli dëgjon të gjithë folësit e regjistruar dhe nëse kohë anuk mjafton, folësit e tjerë marrin fjalën në Mbledhjen e radhës. Sipas rregullores një qytetar mund të paraqitet për të folur para Këshillit, gjatë periudhës së komenteve për qytetarët, jo më shumë se katër herë në vit dhe jo më shumë se një herë brenda një periudhe tremujore.

Kjo formë pjesëmarrjeje u mundëson qytetarëve të ndjekin nga afër procesin e vendimmarrjes, të informohen mbi diskutimet për çështje të rëndësishme dhe të kuptojnë prioritetet e politikave vendore. Prania e qytetarëve në këto mbledhje rrit transparencën institucionale dhe nxit një kulturë më të fortë të llogaridhënies.

Ndërveprimi i drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e bashkisë, *përmes takimeve, kërkesave për sqarime ose intervistave*, është gjithashtu një mekanizëm i rëndësishëm që u mundëson qytetarëve të marrin informacion plotësues ose të adresojnë shqetësime specifike. Në rast të shkeljes së procedurave administrative ose mungesës së reagimit institucional, qytetarët kanë të drejtë të paraqesin ankesa formale, të cilat duhet të trajtohen në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Përveç mekanizmave të qasjes dhe monitorimit, legjislacioni shqiptar parashikon një sërë instrumentesh të avancuara të pjesëmarrjes direkte dhe ndërhyrjes qytetare në vendimmarrje. Ndër këto instrumente, *referendumi vendor* përbën formën më të fortë të demokracisë direkte në nivel lokal. Në Kodin Zgjedhor është trajtuar edhe çështja që lidhet me nismën për një referendum vendor. Sipas këtij Kodi, nismën për një referendum vendor, për një çështje të qeverisjes vendore, mund ta ushtrojnë: -10 për qind e zgjedhësve të regjistruar në listat e zgjedhësve të njësisë vendore perkatese ose 20 mijë prej tyre, cilado shifër më e vogël. -Një numër këshillash bashkiakë, që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën e popullsisë së një qarku, kanë të drejtë të kërkojnë zhvillimin e një referendumi për një çështje të qeverisjes vendore në nivel qarku. Referendumi vendor mund të mbahet për një çështje të qeverisjes vendore që njëherazi është edhe çështje e rëndësishme së veçantë.<sup>[7]</sup>

---

[7] Neni 132 i Kodit Zgjedhor.



Një tjetër mekanizëm i rëndësishëm është *nisma qytetare*, që u mundëson qytetarëve të propozojnë ndryshime të akteve vendore, rregulloreve, politikave ose projekteve publike. Bashkia dhe Këshilli Bashkiak janë të detyruar të shqyrtojnë dhe t'u përgjigjen këtyre propozimeve në mënyrë të argumentuar. Po ashtu, Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” parashikon detyrimin e organeve publike vendimarrëse qëndrore dhe vendore duke përfshirë këtu edhe Bashkinë për të organizuar konsultime publike përpara miratimit të akteve me ndikim të rëndësishëm. Qytetarët mund të marrin pjesë në këto konsultime, të dorëzojnë komente me shkrim dhe të kërkojnë përgjigje zyrtare mbi shqetësimet e ngritura. Iniciativa qytetare ndërmerren nga jo më pak se një përqind e qytetarëve pranë një bashkie, e cila ka për qëllim tu japi mundësi këtyre të fundit të paraqesin problematika me të cilat hasen në përditshmëri.<sup>[8]</sup>

Mekanizma të tjerë plotësues që mund të përdoren nga qytetarët në nivel vendor, përfshijnë *peticionet qytetare*. Në dallim nga mekanizmi i informimit dhe konsultimit publik i cili është një proces që iniciohet nga Bashkia, peticionet qytetare iniciohen nga vetë qytetarët. Ato mund të depozitohen për çështje të ndryshme komunitare dhe detyrojnë institucionin të japë një përgjigje zyrtare; si dhe buxhetimin me pjesëmarrje, që u jep qytetarëve mundësinë të kontribuojnë në përcaktimin e prioriteteve të investimeve publike në fazën e hartimit të buxhetit vjetor.

Po ashtu, *e drejta për t'u ankuar* pranë çdo institucioni publik përfshirë këtu edhe institucionet vendore është një e drejtë themelore e sanksionuar që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.<sup>[9]</sup> Në nenin 48 të saj parashikohet se: “Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.”

Një element tjetër thelbësor i përfshirjes qytetare është *monitorimi i faqes zyrtare të Bashkisë Pukë*, ku publikohen informacione të detyrueshme sipas Programit të Transparencës. Ky program përfshin publikimin e vendimeve, buxhetit, raporteve financiare, shpalljeve të prokurimeve dhe dokumenteve të tjera të rëndësishme për funksionimin e institucionit. Monitorimi i këtij informacioni u mundëson qytetarëve të verifikojnë zbatimin e detyrimeve ligjore dhe të jenë të informuar në kohë reale mbi aktivitetet e bashkisë.

Përdorimi i të gjithë instrumenteve të sipërcituara, qasja në informacion, pjesëmarrja në mbledhje, monitorimi i transparencës, takimet me administratën, referendumi, nisma qytetare, konsultimi publik, peticionet dhe buxheti me pjesëmarrje u jep qytetarëve mundësinë reale të ndikojnë në qeverisjen e komunitetit të tyre. Këta mekanizma forcojnë transparencën, rrisin llogaridhënien dhe nxisin një kulturë më të fortë të pjesëmarrjes demokratike në nivel vendor.

[7] Neni 132 i Kodit Zgjedhor.

[8] <https://www.kas.de/documents/271859/0/Udhezues+mbi+Nismat+Qytetare+ne+Qeverisjen+Vendore+%2810%29.pdf/ff7bdc3a-b962-2330-1c56-ad9d29f4ead2?version=1.0&t=1712670421148>

[9] Neni 48 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

# XI. NIVELI AKTUAL I INFORMIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT QYTETAR MBI PLANET E INTEGRITETIT TË BASHKISË PUKË




Në përmbushje të parimeve të mësipërme, me qëllim matjen e nivelit të informimit të qytetarëve që janë bërë pjesë e sesioneve të informimit dhe konsultimit është administruar një pyetësor jo në formën e një ankete i cili është shpërndarë tek pjesëmarrësit përgjatë sesioneve të konsultimit. Përgjigjet e dhëna nuk përbëjnë rezultatet e një ankete të mirfilltë por ka pasur si qëllim lehtësimin e përpunimit të të dhënave mbi njohuritë për Planin e Integritetit të qytetarëve të përfshirë në sesionet informuese dhe konsultative të realizuar. Rezultatet e përpunuara kanë orientuar më tej hapat e ndërmarra për monitorimin e zbatueshmërisë së PI-së dhe nivelin e përfshirjes qytetare. Monitorimi ka një natyrë të veçantë pasi edhe pse i realizuar nga ekspertë të fushës, ka përdorur të gjitha metodat monitoruese që një qytetar mund të ketë dispozicion si qytetar i Bashkisë dhe si vizitor i jashtëm kritik.

## -Njohja me dokumentin e planit të integritetit të Bashkisë Pukë

1. A e dini se çfarë është Plani i Integritetit i Bashkisë Pukë dhe çfarë përfshin ai?


11 responses



*Grafik Nr. 1*

2. A jeni njohur me planin konkret të veprimit për zbatimin e Planit të Integritetit të Bashkisë Pukë?

11 responses



*Grafik Nr. 2*




Sipas Grafikut nr. 1, nga 11 persona që kanë plotësuar intervistat në formën e një pyetësori online, ka rezultuar se lidhur me pyetjen për njohuritë mbi Planin e Integritetit të Bashkisë Pukë, **27.3% (3 persona)** kanë deklaruar se e njohin mirë Planin e Integritetit, **54.5% (6 persona)** janë shprehur se kanë dëgjuar për ekzistencën e tij, por nuk disponojnë informacion të plotë mbi përmbajtjen, ndërsa **18.2% (2 persona)** kanë deklaruar se nuk kanë dijeni për ekzistencën e planit.

Ndërsa sipas grafikut nr. 2, nga 11 persona që janë përgjigjur, lidhur me njohjen e planit konkret të veprimit të Bashkisë Pukë, **27.3% (3 persona)** janë shprehur se janë të informuar mbi përmbajtjen dhe masat konkrete të planit, **18.2% (2 persona)** kanë deklaruar se disponojnë njohuri të pjesshme, ndërsa **54.5% (6 persona)** kanë deklaruar se nuk kanë informacion mbi të.

Nga analiza krahasimore e Grafikut nr. 1 dhe Grafikut nr. 2 rezulton se ka një dallim të qartë midis nivelit të njohjes së përgjithshme të Planit të Integritetit dhe njohjes së aspekteve konkrete të zbatimit të tij në Bashkinë Pukë. Ndërsa **81.8%** e pjesmarrësve deklarojnë se kanë, të paktën, një njohje fillestare mbi ekzistencën e planit, vetëm **27.3%** shprehen se janë të informuar mbi masat dhe veprimet konkrete të tij. Për rrjedhojë, të dhënat nënvizojnë nevojën për përpjekje më të shtuara në drejtim të ndërgjegjësimit publik, me fokus në aspektet praktike të Planeve të Integritetit të tilla si objektivat dhe komponentët përbërës, rëndësia si dhe faza e zbatueshmërisë.

### -Transparenca e Bashkisë Pukë nën optikën e perceptimit qytetar

3. Si e vlerësoni transparencën e Bashkisë Pukë në publikimin e informacionit mbi integritetin dhe anti-korrupsionin?  
11 responses




*Grafik Nr. 3*



4. A mendoni se qytetarët janë të informuar mjaftueshëm për aktivitetet dhe masat që lidhen me integritetin në bashki?

11 responses



**Grafiku Nr. 4**

Lidhur me vlerësimin e transparencës së Bashkisë Pukë, nga **11 persona, 45.5% (5 persona)** e kanë vlerësuar transparencën si shumë të mirë, **36.4% (4 persona)** si të mirë, ndërsa **27.3% (3 persona)** si mesatare, pa asnjë vlerësim negativ. Këto rezultate reflektojnë një perceptim përgjithësisht pozitiv të pjesëmarrësve mbi përpjekjet e Bashkisë Pukë për publikimin e informacionit, duke treguar se masat e ndërmarra në fushën e transparencës janë të dukshme dhe të vlerësuara nga qytetarët.


Ndërkohë, lidhur me nivelin e informimit të qytetarëve mbi aktivitetet dhe masat që lidhen me integritetin në Bashki, **36.4% (4 persona)** janë shprehur se ndihen të informuar, **54.5% (6 persona)** se janë të informuar deri diku, ndërsa **9.1% (1 person)** ka deklaruar se nuk ndihet i informuar.

Nga krahasimi i të dhënave nga grafiku 3 dhe grafiku 4, rezulton se ndonëse transparenca e Bashkisë Pukë vlerësohet përgjithësisht pozitivisht nga shumica e pjesëmarrësve (**81.9% e vlerësojnë si shumë të mirë ose të mirë**), niveli i informimit të qytetarëve mbi aktivitetet dhe masat konkrete që lidhen me integritetin rezulton më i moderuar. Fakti që **54.5%** e pjesëmarrësve ndihen vetëm pjesërisht të informuar sugjeron se, pavarësisht perceptimit pozitiv mbi transparencën, ekziston nevoja që informacioni të jetë më i qartë, më i strukturuar dhe më lehtësisht i aksesueshëm për qytetarët.



5. A keni marrë ndonjëherë informacion, njoftim apo ftesë për të dhënë mendim mbi çështje që lidhen me integritetin apo transparencën në Bashkinë Pukë?

11 responses




**Grafiku Nr. 5**

Sipas Grafikut nr. 5, lidhur me përfshirjen e qytetarëve përmes kontributit konkret në zbatimin e Planit të Integritetit, nga 11 persona 54.5% (6 persona) kanë deklaruar se kanë marrë informacion ose ftesa për të dhënë mendim mbi çështje që lidhen me integritetin dhe transparencën, ndërsa 45.5% (5 persona) kanë deklaruar se nuk kanë marrë një informacion të tillë.

Këto të dhëna tregojnë se proceset e konsultimit publik janë të pranishme dhe funksionale për një pjesë të konsiderueshme të qytetarëve. Megjithatë, fakti që pothuajse gjysma e të qytetarëve që janë përgjigjur nuk kanë qenë të përfshirë në këto procese sugjeron se ekziston hapësirë për zgjerimin dhe forcimin e mekanizmave të informimit dhe përfshirjes, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes qytetare në zbatimin e Planit të Integritetit.

7. A keni përjetuar ndonjë vështirësi ose situatë që lidhet me mungesë integriteti gjatë marrjes së shërbimeve publike nga Bashkia Pukë?

11 responses



**Grafik Nr. 6**


Për pyetjen mbi përjetimet apo vështirësitë e hasura në marrjen e shërbimit pranë Bashkisë Pukë, të identifikuar apo të përceptuara si mungesë integriteti apo veprime të lidhura me korrupsionin, të gjithë personat e përgjigjur janë shprehur se nuk kanë përjetuar situata që lidhen me mungesë integriteti gjatë marrjes së shërbimeve publike. **Ky rezultat përbën një tregues shumë pozitiv të perceptimit të qytetarëve mbi korrektësinë dhe integritetin në ofrimin e shërbimeve publike nga Bashkia Pukë.**



## -Njohuritë mbi mekanizmat e raportimit të korrupsionit pranë Bashkisë

8. A dini nëse Bashkia Pukë ka mekanizma për raportimin anonim të praktikave të korrupsionit apo sjelljeve të pahijshme?

11 responses




**Grafik Nr. 7**

Pyetjes lidhur me njohurinë e qytetarëve mbi ekzistencën e mekanizmave për raportimin anonim të korrupsionit pranë Bashkisë Pukë i janë përgjigjur 11 persona. Nga këta, 5 persona kanë deklaruar se janë të informuar mbi ekzistencën e këtyre mekanizmave, 5 persona janë shprehur se nuk janë të sigurt për ekzistencën ose funksionimin e tyre, ndërsa 1 person ka deklaruar se nuk ka dijeni mbi këto mekanizma.

Këto rezultate tregojnë se mekanizmat e raportimit anonim janë të njohur nga një pjesë e qytetarëve, duke reflektuar përpjekjet e institucionit në këtë drejtim. Njëkohësisht, prania e një numri të konsiderueshëm qytetarësh që shprehen të pasigurt sugjeron se forcimi i informimit publik dhe qartësimi i procedurave përkatëse do të kontribuonin në rritjen e ndërgjegjësimit, besimit dhe përdorimit efektiv të këtyre mekanizmave.

9. Sa të sigurt do të ndiheshit për të raportuar një rast korrupsioni apo shkeljeje etike në Bashki?

11 responses



**Grafik Nr. 8**

Lidhur me pyetjen mbi nivelin e sigurisë që qytetarët do të ndiheshin për të raportuar një rast të mundshëm korrupsioni pranë Bashkisë Pukë, nga 11 persona të përgjigjur, 4 persona janë shprehur se do të ndiheshin shumë të sigurt, 5 persona janë shprehur të sigurt, ndërsa 3 persona janë shprehur pak ose aspak të sigurt.



Këto rezultate tregojnë se shumica e qytetarëve shfaqin një nivel të konsiderueshëm sigurie për të raportuar raste të tilla, duke reflektuar një perceptim përgjithësisht pozitiv ndaj institucionit dhe mekanizmave të raportimit. Megjithatë, në një analizë krahasuese me gjetjet e paraqitura në grafikët e mësipërm, mund të konstatohet se niveli i pasigurisë i reflektuar nga një pjesë e qytetarëve të përgjigjur mund të lidhet me grupin e qytetarëve që nuk kanë njohuri të qarta mbi ekzistencën e mekanizmave të raportimit anonim dhe mbi mënyrën e funksionimit të tyre. Në këtë kuadër, adresimi i këtyre elementeve përmes informimit më të strukturuar dhe rritjes së transparencës procedurale pritet të kontribuojë në forcimin e mëtejshëm të besimit dhe sigurisë së qytetarëve në përdorimin e mekanizmave ekzistues të raportimit.

Në përfundim të analizës së përceptimit qytetar si dhe eksperiencave të jetuara, lidhur me pyetjen e adresuar se cilat aspekte konsiderohen nga qytetarët si prioritare për t'u përmirësuar në drejtim të rritjes së integritetit në Bashkinë Pukë. 4 nga 11 persona kanë deklaruar se e konsiderojnë prioritare përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, 3 nga 11 persona konsiderojnë prioritare transparencën dhe publikimin e informacionit, 3 persona e konsiderojnë prioritare përmirësimin e procedurat dhe ofrimin e shërbimeve, ndërsa 2 persona luftën kundër korrupsionit dhe menaxhimin e burimeve njerëzore. Në pyetjen e parashtryar qytetarët kishin mundësinë të zgjidhnin më shumë se një opsion përgjigjeve.

**Këto gjetje reflektojnë pritshmëritë e qytetarëve për një administratë gjithnjë e më të hapur, transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke ofruar orientim të vlefshëm për përmirësime të mëtejshme institucionale.**

## XII.GJETJE KRYESORE



- Plani i Integritetit i Bashkisë Pukë përbën një instrument parandalues të rëndësishëm në kuadër të forcimit të integritetit institucional dhe minimizimit të riskut të korrupsionit. Nga vlerësimi i kryer rezulton se Plani është në proces zbatimi dhe funksionon si një mekanizëm progresiv, ndonëse objektivat e parashikuara nuk janë përmbushur plotësisht brenda afatit fillestar. Megjithatë, Bashkia Pukë ka vepruar në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke ndërmarrë procedurat e nevojshme për shtyrjen e afatit të zbatimit, me qëllim garantimin e përmbushjes së plotë të masave të parashikuara deri në muajin gusht 2026.
- Analiza e të dhënave të mbledhura përmes pyetësorëve të qytetarëve, informacionit zyrtar të përcjellë nga Bashkia Pukë dhe verifikimit të përmbajtjes së faqes zyrtare të institucionit tregon se qytetarëve u është garantuar mundësia për t'u përfshirë në proceset vendimmarrëse të Bashkisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi dhe parimet e qeverisjes vendore. Këto mekanizma pjesëmarrjeje rezultojnë të jenë funksionale dhe të aksesueshme për publikun.
- Gjithashtu, Programi i Transparencës dhe informacionet e tjera të detyrueshme rezultojnë të jenë të publikuara në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Informacioni i publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Pukë është i organizuar në një mënyrë që mundëson akses të lehtë dhe përdorim funksional nga ana e qytetarëve dhe palëve të interesuara.
- Megjithatë, si mangësi evidentohet mungesa e informimit të strukturuar, të rregullt dhe të dokumentuar të publikut lidhur me fazat konkrete të zbatimit të Planit të Integritetit. Konkretisht, nuk rezulton të jetë i publikuar një dokument i vetëraportimit periodik nga ana e Bashkisë Pukë mbi nivelin e realizimit të masave, progresin e arritur dhe sfidat e evidentuara gjatë zbatimit të Planit të Integritetit, çka kufizon transparencën dhe mundësinë e monitorimit publik.
- Nga analiza e raporteve të monitorimit të hartuara nga AMVV rezulton se informacioni i paraqitur është kryesisht i orientuar në nivel teknik, çka e bën procesin e monitorimit më pak të aksesueshëm dhe të kuptueshëm për publikun e gjerë. Raportet nuk paraqiten gjithmonë në një formë të qartë dhe të detajuar që të mundësojë një pasqyrë të plotë dhe të kuptueshme mbi ecurinë e procesit, duke kufizuar rolin e tyre në funksion të transparencës dhe llogaridhënies publike.

## XIII.REKOMANDIME



- Në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit të zbatimit të Planit të Integritetit, rekomandohet që Bashkia Pukë të institucionalizojë procesin e vetëmonitorimit përmes hartimit dhe publikimit të raporteve periodike mbi ecurinë e zbatimit të Planit. Këto raporte duhet të përmbajnë informacion të detajuar mbi masat e realizuara, masat në proces, afatet kohore, strukturat përgjegjëse, si dhe problematikat e hasura gjatë zbatimit, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe besimit publik.
- Gjithashtu, rekomandohet që Bashkia Pukë të strukturojë dhe konsolidojë informacionin mbi Planin e Integritetit në faqen zyrtare të institucionit, përmes krijimit të një seksioni të posaçëm dhe të dedikuar. Ky seksion duhet të përfshijë dokumentin bazë të Planit të Integritetit, vendimet përkatëse për miratimin dhe shtyrjen e afatit, raportet periodike të zbatimit, si dhe informacion shpjegues mbi objektivat dhe rëndësinë e Planit, në mënyrë që publiku të ketë një pasqyrë të qartë dhe të plotë mbi procesin.
- Rekomandohet gjithashtu forcimi i komunikimit publik mbi masat antikorruption dhe rezultatet e arritura në kuadër të Planit të Integritetit, përmes përdorimit të kanaleve të ndryshme të komunikimit institucional, përfshirë njoftimet publike, rrjetet sociale dhe aktivitetet informuese me qytetarët. Një komunikim më aktiv dhe i vazhdueshëm do të kontribuonte në rritjen e ndërgjegjësimit publik dhe në përmirësimin e perceptimit mbi angazhimin e Bashkisë në drejtim të integritetit dhe qeverisjes së mirë.
- Në këtë kuadër, rekomandohet që AMVV, në hartimin e raporteve të monitorimit, të adoptojë një qasje më të qartë, të detajuar dhe gjithëpërfshirëse, duke e bërë procesin e monitorimit më të hapur dhe më transparent për publikun. Raportet e monitorimit duhet të mos mbeten vetëm në nivel teknik, por të orientohen drejt forcimit të transparencës dhe llogaridhënies, përmes përdorimit të një gjuhe të thjeshtë, të strukturuar dhe të kuptueshme, e cila mundëson leximin dhe interpretimin e informacionit edhe nga qytetarë me njohuri të paktën mesatare të të lexuarit dhe të kuptuarit. Një qasje e tillë do të kontribuonte në rritjen e aksesueshmërisë së informacionit dhe në fuqizimin e rolit të qytetarëve në monitorimin e politikave publike.
- Në vijim, rekomandohet që Bashkia Pukë të vlerësojë mundësinë e përfshirjes së aktorëve të jashtëm, si përfaqësues të shoqërisë civile, grupe interesi apo struktura këshillimore lokale, në proceset e informimit dhe monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit. Një qasje e tillë do të forconte mekanizmat e llogaridhënies, do të rriste transparencën institucionale dhe do të kontribuonte në ndërtimin e një partneriteti më të qëndrueshëm me komunitetin lokal.

# XIV.REFERENCA



## • Akte Ligjore dhe dokumenta Zyrtarë

- Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC)
- Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Kodi Zgjedhor
- Strategjisa Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2024-2030

## • Linqe Publikimi

- Plani i Integritetit i Bashkisë Pukë [https://bashkiapuke.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/PI\\_Bashkia-Puke-1.pdf](https://bashkiapuke.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/PI_Bashkia-Puke-1.pdf)
- <https://bashkiapuke.gov.al/ep-content/uploads/2022/11/Projekt-Vendim-04-date-29.06.2022-Plani-i-integritetit-.pdf>
- <https://qeverisjavendore.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Bashkia-Puke.docx>
- Raport mbi Monitorimin e Planeve të Integritetit – Bashkia Pukë
- <http://bashkiapuke.gov.al/programi-transparences/>
- <https://bashkiapuke.gov.al/wp-content/uploads/2025/08/Projekt-vendim-Per-shtyrjen-me-nje-vit-te-planit-te-integritetit.pdf>
- <https://www.kas.de/documents/271859/0/Udhezues+mbi+Nismat+Qytetare+ne+Qeverisjen+Vendore+%2810%29.pdf/ff7bdc3a-b962-2330-1c56-ad9d29f4ead2?version=1.0&t=1712670421148>

**RAPORT**  
**NGA ANGAZHIMI INSTITUCIONAL**  
**TE VEPRIMI QYTETAR:**  
**MONITORIMI I ZBATUESHMËRISË SË PLANIT TË**  
**INTEGRITETIT TË BASHKISË PUKË (2024)**



**Together for Life**

Mobile: +355692066522

Email: [info@togetherforlife.org.al](mailto:info@togetherforlife.org.al)

Adresa: Rr. Brigada VIII, Tiranë

Website: [www.togetherforlife.org.al](http://www.togetherforlife.org.al)